



Imzot Giovanni Peragine CCRSP
Ispeshkvi Titullar i Finiqit
Administrator Apostolik
i Shqipërisë së Jugut

“Ndiz një dritë shprese”

Shumë të dashur,

prej kohësh po marrim pjesë në vendin tonë, në një debat të fortë politik që rrezikon ta çojë vendin në një krizë të vërtetë, edhe shoqërore, me pasoja të paparashikueshme, përveç se e detyron Shqipërinë të përballet sërish me fantazmat e të shkuarës së mjerueshme dhe pa asnjë formë lirie e shprese.

Të shumta dhe të padëguara kanë qënë thirrjet drejtuar autoriteteve politike edhe nga ana e institucioneve fetare të vendit, që të dorëzojnë armët e arrogancës dhe të interesave mënjane dhe të dëgjojnë zërin e shumë njerëzve të cilët, të lodhur dhe të zhgënjyer ndaj shumë premtimeve, janë ende të detyruar të lënë vendin e tyre në kërkim të një jete më të mirë.

Përballë kësaj situatë dëshirojmë t’i drejtojmë Zotit lutjet tona për paqe në tokën tonë të dashur që nuk meriton të vazhdojë të vuajë për shkak të egoizmit të pak njerëzve.

Prandaj u bëj thirrje të gjithë besimtarëve të Administraturës Apostolike të Shqipërisë së Jugut, dhe gjithë shqiptarëve me vullnet të mirë, për një ditë lutjeje dhe agjërimi të caktuar për **Të Premten 21 qershor**, si edhe për të marrë pjesë në iniciativën **“Ndiz një dritë shprese”**: nga ora 21:00 deri në 22:00 duke iu drejtuar Zotit, ndiz një qiri në shenjë shprese, duke e vendosur në një nga dritaret e shtëpisë tënde.

Zoti e dëgjoftë zërin e popullit të tij që e kërkon dhe i ngohet zemrat e qeveritarëve tanë derisa të gjejnë një zgjidhje paqësore për të mirën e Shqipërisë sonë.

Vlorë 19.06.2019

+p.giovanni peragine